



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2984/Prot.

Tiranë, më , 26.11 2021

1

VENDIM

Nr. 50 ,datë 25.11.2021

“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË DISA NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË FAKULTETIT TË EKONOMISË, TË UT-SË”

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma ç), të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31, gërma dh), të Statutit të UT-së; në propozimin e Fakultetit të Ekonomisë, të përcjellë me shkresën nr.943, datë 08.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në strukturën organizative, në Fakultetin e Ekonomisë, në lidhje me emërtesat dhe numrin në plan të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, konkretisht:

I. Biblioteka	5
a.Përgjegjës Biblioteke	1
b.Bibliotekar	4
II. Dega e Ekselencës dhe projekteve	3
a.Kryetar dege	1
b.Specialist për aplikimet	2
III. Dega e Procesit mësimor (Bachelor dhe Master)	12
a. Kryetar dege	1
b.Specialist per bachelor dhe master	1
c.Specialist për praktika dhe konfirmim dokumentacioni	1
d.Specialist për procesin mësimor dhe pranë departamenteve	9

2. Në Degën e Kualifikimit Shkencor: emërtesa “*specialist i shkollës së doktoraturës*”, ndryshon në emërtesën “*specialist i programeve të studimeve doktorale*”.

3. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të UT-së.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha